

VENDIM
Nr.185, datë 10.4.2004

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES TË
DISA NGASTRAVE PYJORE, PJESE TË EKONOMISË PYJORE ZALL-HERR —PRISKË,
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të nenit 7 të ligjit nr.7623, datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe Policinë e Shërbimit Pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngastrat pyjore me numrat rendorë nga 59-82 dhe me sipërfaqe 693 ha, pjesë të ekonomisë pyjore Zall-Herr—Priskë, të kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për t’u përdorur për ngritjen e mjedisit stërvitor qendror të Komandës së Forcave Tokësore.

2. Ngastrat pyjore të përcaktuara në pikën 1 të përfshihen në pronën nr.157, me emërtimin “brigada e tankeve”, komuna Zall-Herr, Tiranë të listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Komanda e Forcave Tokësore dhe Shoqata e Përdorimit të Ujit, Zall-Herr të lidhin marrëveshje të përbashkët për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ujëmbledhësve nr.1 dhe nr.2, në Zall-Herr, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 6.8 ha, të cilat përfshihen në territorin ku do të ngrihet mjedisi stërvitor qendror i kësaj komande.

4. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano